REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6682 prot Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT
PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputeti Sali BERISHA,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Neni 1

Pas nenit 3, shtohet neni 3/1 me titull "Minimumi jetik", me përmbajtjen si më poshtë vijon:

"Brenda muajit mars 2027 me propozim të Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Shqipërisë miraton me ligj të vecantë vlerën financiare të minimumit jetik në Republikën e Shqipërisë.

Duke filluar nga data 1 prill 2027, pagesat për pensionet e pleqërisë, pagesat për pensionet e invaliditetit dhe aftësisë së kufizuar, pagesat e familjeve në ndihmë ekonomike, pagesat për bursat studentore dhe kategori të tjera të vecanta sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave, nuk duhet të jenë më të ulta se vlera financiare e miratuar e minimumit jetik.

Vlera financiare e minimumit jetik e përcaktuar me ligj në cdo rast nuk mund të jetë më e ulët se 20 mijë lekë/muaj".

Neni 2

Këto shtesa të pasqyrohen në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN: PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN

"PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga vlerësimi se në një rend demokratik dhe shoqëri plurale, çdo qytetar duhet të gëzojë të drejta dhe detyrime të njëjta para ligjit dhe ku shteti duhet të përmbushë misionin social përkundrejt gjithësecilit.

Nisur nga fakti se secilit qytetar duhet t'i garantohet pjesëmarrja aktive në shoqëri, duke i mundësuar instrumentat e duhura financiare për të patur një jetesë dhe mirëqënie dinjitoze e vazhdueshme.

Nisur nga fakti se mungesa e përkufizimit të minimumit jetik kombëtar në legjislacionin mbështetës për mbrojtjen sociale, ka ndikuar negativisht në hartimin e politikave të duhura për sigurinë sociale, përdorimin e metodologjisë për vlerësimin e masës së ndihmës së skemave financiare, për të përmbushur kësisoj misionin social të vetë shtetit për të garantuar mirëqënie dhe dinjitet për çdo qytetar.

Nisur nga gjendja reale e ekonomisë shqiptare dhe aktorëve të tregut, ku fatkeqësisht kryefjala në tryezat e pothuajse gjysmës së popullatës shqiptare është mjerimi dhe varfëria.

Nisur nga fakti se rreth 550 mijë pensionistë aktualisht marrin një pension mujor me vlerë më të ulët sesa 20 mijë lekë (apo 220 euro).

Nisur nga fakti që në 13 vite të qeverisjes narko-rilindase pensionet jo vetëm që nuk kanë përjetuar rritje reale, por edhe indeksimet e ndërmarra kanë qenë pjesore, duke rezultuar vazhdimisht në një ulje të fuqisë reale blerëse të pensionistëve shqiptarë.

Nisur nga fakti së qindra mijëra shqiptarë që fatin e tyre e kanë të varur nga pagesat e ndihmës ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizuar.

Nisur nga fakti se vendosja e minimumit jetik prej të paktën 20 mijë lekë do të përkthehet në një nxitës të fuqishëm të konsumit.

Nisur nga fakti se vendosja e minimumit jetik prej të paktën 20 mijë lekë do të ulë sadopak hendekun e thellë të pabarazive në nivelin e të ardhurave.
Nisur nga pritshmëria që vendosja e minimumit jetik të japë një kontribut pozitiv në parandalimin e emigracionit ekonomik.
Dhe gjithashtu nisur nga qëndrimi ynë i palëkundur se nuk mund të pretendojmë për rritje ekonomike, zhvillim dhe integrim evropian, ndërkohë që qindra mijëra shqiptarë luftojnë cdo ditë betejën për kafshatën e gojës.

Propozoj që brenda muajit mars 2027 me propozim të Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Shqipërisë të miratojë me ligj të vecantë vlerën financiare të minimumit jetik në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu propozoj që duke filluar nga data 1 prill 2027, pagesat buxhetore për pensionet e pleqërisë, pagesat për pensionet e invaliditetit dhe aftësisë së kufizuar pagesat e familjeve në ndihmë ekonomike, pagesat për bursat studentore dhe kategori të tjera të vecanta sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave, nuk duhet të jenë më të ulta se vlera financiare e miratuar e minimumit jetik. Në cdo rast dhe vlerësim nga ana e ekzekutivit, propozoj që vlera financiare e minimumit jetik e përcaktuar me ligj nuk mund të jetë më e ulët se 20 mijë lekë/muaj (apo 220 euro)".

Dhe së fundmi, me këtë amendament që propozohet, synohet marrja e një angazhimi serioz të përvitshëm, në mënyrë që vakumi normativ i përcaktimit të minimumit jetik kombëtar të përfundojë sa më parë dhe të vendoset një standart normativ me efekte të drejtpërdrejta në politikat sociale dhe ekonomike të vendit.

Deputeti

Sali BERISHA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE ✓

Nr. 6734 prot

Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputeti Sali BERISHA,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 12, paragrafi 5 riformulohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

Fondi për politikat e reja të pagave, prej 40 miliardë lekësh do të përdoret për rritjen e pagave të të gjithë punonjësve të administradës publike, me të paktën 30% për pagat më të larta se paga mesatare 2026 dhe me të paktën 50% për pagat më të ulta se paga mesatare 2026, duke filluar nga 1 Janari 2027, sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
Përjashtohen nga rritja e pagave pozicionet e larta drejtuese të administratës publike dhe pozicionet me emërime politike.

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION
PËR AMENDAMENTIN: PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga qëndrimi ynë për një administratë njëkohësisht të vogël, por eficiente dhe të mirëpaguar, në nivele të ngjashme me vendet e rajonit.

Nisur nga fakti se punonjësit me paga të ulta, sidomos ata me paga deri ne 100 mijë lekë në muaj nuk ja dalin dot të përballojnë denjësisht nevojat e tyre për shpenzime familjare dhe personale.

Nisur nga fakti që mësuesit, pedagogët, mjekët, infermierët, policët, ushtarakët, punonjësit e shërbimeve, punonjesit deri në nivelin e mesëm drejtues të administratës, etj, janë masivisht të shkurajuar për të shërbyer në administratën publike, duke përfaqësuar edhe një pjesë të konsiderueshmë të kontingjentit migrator të vendit.

Nisur nga rënia e fuqisë blerëse si pasojë e rritjes së vazhdueshme të cmimeve, përfshirë edhe ato të pasurive të paluajtshme,

Nisur nga mungesa e motivimit financiar për të kryer detyrën e tyre, e cila ka rezultuar në rënie të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve, dhe jo vetëm:

Propozoj alokimin e një fondi prej 40 miliardë lekë, që të përdoret me qëllim rritjen me të paktën 30% për pagat më të larta se paga mesatare 2026 dhe me të paktën 50% për pagat më të ulta se paga mesatare 2026, duke filluar efektet e saj që nga 1 janar 2027. Gjithashtu në këtë propozim përjashtohen nga rritja e pagave pozicionet e larta drejtuese të administratës publike dhe pozicionet me emërime politike

Ky fond i dedikuar për rritjen me e pagave mund të sigurohet nga rialokimi i fondeve të parashikuara për shpenzimet operative të qeverisjes qëndrore, projekteve për rikonstruksione zyrash dhe mobilime, rishikimit të prioriteteve dhe financimit të projekteve të reja të investimeve publike dhe pezullimi i pagesave për PPP-të me mbështetje buxhetore, pa cënuar nivelet e parashikuara të deficitit vjetor buxhetor.

Deputeti

Sali BERISHA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6706 prot Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputeti Bujar Leskaj,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 11, pas pikës 7, shtohet pika 8, me përmbajtje si vijon:

Në buxhetin e vitit 2027, fondet e parashikuara për shpenzimet operative të qeverisjes qëndrore të planifikohen të paktën 20% më të ulta krahasuar me planifikimin e buxhetit 2026.
Nga ky rregull bëjnë përjashtim fondet e dedikuara për pagesat e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, pagesat e shërbimeve që kanë lidhje me shëndetin, sigurinë kombëtare, rendin publik apo sigurinë e jetës dhe pronës".

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN: PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga fakti se shpërdorimet me buxhetin e shtetit janë kthyer në normë për qeverisjen ne fuqi, dhe nga fakti se të shumta janë jo vetëm denoncimet por edhe ndjekjet penale në lidhje me abuzimet e fondeve buxhetore.

Nisur nga fakti se taksat e shqiptarëve të ndershëm nuk administrohen në shërbim të ekonomisë dhe fuqizimit të familjes dhe aktorëve të tregut, por për të ushqyer babëzinë dhe orekset e qeveritarëve.

Nisur nga fakti se ndërkohë që mjerimi dhe varfëria janë ulur këmbëkryq në tryezat e shqiptarëve, ku të paktën 2 në cdo 5 shqiptarë jetojnë në kushtet e varfërisë dhe privimit social dhe material, qeveria mendjen e ka tërësisht dhe vetëm te lukset, duke abuzuar, vjedhur e braktisur shqiptarët e ndershëm.

Për këto arsye të renditura më lart dhe shumë të tjera që nuk po i përmend, propozoj para jush një vendimmarrje sa të fortë po aq edhe kurajoze, një vendimmarrje në interes të shtresave në nevojë dhe rritjes së eficiencës së përdorimit të parasë publike.

Propozoj që në buxhetin e vitit 2027 të ulen me 20% fondet e shpenzimeve operative të qeverisjes qëndrore krahasuar me buxhetimin e këtyre fondeve për vitin korent 2026. Gjithashtu me qëllim ofrimin e pandrërprerë të disa shërbimeve bazë, propozoj të përjashtohen nga ky propozim ato zëra shpenzimesh që kanë lidhje me shëndetin, sigurinë kombëtare, rendin publik, sigurinë e jetës dhe pronës, vendimet gjyqësore të formës së prerë.

Gjithashtu vlerësoj se fondet e kursyera nga kjo iniciativë e propozuar, të cilat parashikohen rreth 250 milionë euro, të alokohen për rritjen e pagave, ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

Deputeti

Bujar LESKAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6689 prot

Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputetët Eno Bozdo dhe Zija Ismaili,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në tabelën 1 "Buxheti 2027 sipas ministrive të linjes dhe institucioneve buxhetore", në rreshtin 6 "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë", programi "transporti rrugor" në kolonën "Totali i Shpenzimeve Kapitale", vlera "30.868.486" zëvendësohet me vlerën "31.368.486".

Neni 2

Shtesa prej 500.000 mijë lekë të alokohen për financimin 2027 të projektit "Rikonstruksion i plotë i rrugës Berat-Polican-Skrapar" dhe projektit "Rikonstruksion i plotë i rrugës Gjerbes-Teqia e Kulmakut".

Neni 3

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN

"PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga takimet e shumta me qytetarë dhe banorë të zonave të ndryshme, urbane dhe rurale të qarkut Berat.

Nisur nga kërkesat e shumta të banorëve të zonave të cilat prej vitesh nuk shohin të kryhen investime në zonat e tyre të banimit dhe punës.

Nisur nga nevojat e konstatuara për përmirësimin e infrastrukturës rrugore në disa akse të rëndësishme brenda qarkut Berat, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetesës së banorëve por edhe të bizneseve të zonës.

Nisur nga rëndësia e kryerjes së disa investimeve të cilat prekin madje më shumë se një njësi të qeverisjes vendore.

Me qëllim përfaqësimin e shqetësimeve dhe zërit qytetar të qarkut që përfaqësoj.

Propozojmë financimin e dy projekteve rrugore në buxhetin e vitit 2027, konkretisht:

- *"Rikonstruksion i plotë i rrugës Berat-Polican-Skrapar" me vlerë të plotë financimi prej 15 milionë euro, dhe*
- *Projekti "Rikonstruksion i plotë i rrugës Gjerbes-Teqia e Kulmakut" me vlerë të plotë 8 milionë euro.*

Propozoj që financimi 2027 për këto dy projekte të jetë të paktën në masën mbi 20% të vlerës së parashikuar të dy projekteve.

Këto fonde të rialokohen nga fondet e dedikuara për shpenzimet operative të qeverisjes qëndrore, pa cënuar nivelet e planifikuara të deficitit buxhetor 2027.

Deputetët

Eno BOZDO **Zija ISMAILI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6690 prot

Tiranë 24/11/2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputeti Eno Bozdo,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 14, pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me përmbajtje si më poshtë vijon:

"Fondi i kontingjencës prej 4.5 miliardë lekë do të shpërndahet brenda muajit mars 2027 me qëllim shuajen e detyrimeve të ndërsjellta midis tre kompanive publike të sektorit energjitik, dhe detyrimeve të ndërsjellta midis tyre dhe palëve të treta, sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave brenda muajit janar 2027 ".

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN: PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga stoku tejet i lartë i detyrimeve të ndërsjellta midis KESH, OST, OSHEE, shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve (UK), ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore, ministrisë së Financave dhe DPTatimeve, stok i cili ka kapur vlerën e pothuajse 176 miliardë leke.

Nisur nga fakti se kjo situatë alarmante është me shqetësim për buxhetin e shtetit, ku vetëm garancitë e paguara nga ministria e Financave kanë ardhur në rritje gjatë viteve të fundit, ku vetëm në 2025 arriti në vlerën prej 2.26 miliardë lekë.

Nisur nga fakti se vetë relacioni shoqërues i këtij projek-buxheti pranon haptazi perfomancën tejet të dobët të UK-ve.

Nisur nga shqetësimi se me kalimin e viteve kjo situatë do të degradojë akoma edhe më shumë, me pasoja akoma edhe më të rënda për financat publike dhe shëndetin e kompanive të sektorit energjitik.

Nisur edhe nga qëndrimi se nevojitet një trajtim dhe vendimmarrje politike për të adresuar këtë situatë alarmante.

Ndaj për arsyet e parashtruara më lart, por jo vetëm, propozoj miratimin e një fondi kontingjence prej 4.5 miliardë lekë (50 milionë euro), me qëllim fillimin e procesit të shuarjes së detyrimeve të ndërsjellta midis tre kompanive publike të sektorit energjitik, dhe detyrimeve të ndërsjellta midis tyre dhe palëve të treta.

Fondi prej 5 miliardë lekë të shpërndahet jo më vonë se muaji mars 2027 sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave, i cili duhet miratuar brenda janarit 2027.

Ky fond kontingjencë prej 4.5 miliardë lekësh, të rialokohet nga fondet e parashikuara për shpenzimet operative të qeverisjes qëndrore (udhëtime, dieta, hotele, karburant, çarter etj.), dhe PPP-të me financim buxhetor, pa cënuar nivelet e defiçit të planifikuar vjetor.

Deputeti
Eno BOZDO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6688 prot Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputeti Tritan Shehu,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në tabelën 1 "Buxheti 2026 institucionet me programe dhe shpenzimet e tjera", në rreshtin 13 "Ministria e Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale", kolonën "Totali i shpenzimeve buxhetore", vlera "89.736.163 mijë lekë" zëvëndësohet me "119.081.483 mijë lekë".

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN
PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga gjendja alarmante në të cilën ndodhet sot sektori i shëndetësisë dhe shërbimi që ky sektor ofron ndaj qytetarëve shqiptarë.

Nisur nga domosdoshmëria evidente për ndërhyrje të qënësishme dhe urgjente me qëllim përmirësimin cilësor të shërbimit, por edhe rritjen sasiore të tij, për tu ardhur sa më shpejt në ndihmë të sëmureve dhe qytetarëve ndaj të cilëve lipset trajtim mjekësor.

Nisur nga nevojat për një infrastrukture moderne, bashkëkohore, multifunksionale të spitaleve dhe qendrave shëndetësore,

Nisur nga nevoja për të rritur pagat e mjekëve, infermierëve dhe personelit mbështetës të tyre, duke i përafruar me pagat e rajonit dhe vendeve të Bashkimit Europian.

Nisur nga financimi buxhetor tejet i ulët i këtij sektori krahasuar me nevojat reale të tij, ashtu sic parashikohet edhe në projektbuxhetin e vitit të ardhshëm nga ana e ekzekutivit shqiptar.

Propozoj rritjen graduale të buxhetit për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në masën 1% të PBB-së cdo vit buxhetor, për të arritur në të ardhmen e afërt(brenda vitit 2029) në nivele jo më të ulta se 5% të PBB-së financim të sektorit shëndetësor.

Efektet financiare në Buxhetin e Shtetit të përballohen nga ulja në të njëjtën masë të shpenzimeve operative qeveritare, kontratave koncesionare/PPP dhe projekteve jo prioritare të investimeve publike të parashikuara për vitin e ardhshëm.

Deputeti

Tritan SHEHU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6687 prot

Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputeti Zija Ismaili,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 18, pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi i dytë me përmbajtje si vijon:

"Gjatë vitit 2027, ministria përgjegjëse për shëndetësinë nuk do të financojë me buxhetin e saj kontratën e mëposhtme koncesionare në sektorin shëndetësor:

"Koncesioni/PPP Ofrimi i Shërbimeve laboratorike spitalore".

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga fakti se gjatë viteve të fundit është konstatuar se koncesionet në sektorin shëndetësor janë shoqeruar me shkelje të shumta ligjore që nga faza e konceptimit e deri te zbatimi i tyre, procedura të cilat janë aktualisht nën hetim/gjykim për klientelizëm, korrupsion dhe shpërdorim detyre nga Struktura e Posacme Anti-Korrupsion.

Nisur edhe nga konstatimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi abuzimet e ndryshme në financimin e kontratave koncesionare,

Nisur nga fakti se qeveria shqiptare nuk mund të vazhdojë të përdorë paratë e taksapaguesve shqiptarë për të financuar afera klienteliste dhe korruptive, sic janë praktikat koncesionare në sektorin e shëndetësisë.

Me qëllim ndalimin një orë e më pare të shpërdorimit dhe vjedhjes së parave të taksapaguesve shqiptarë.

Propozoj që në buxhetin 2027 të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë të mos alokohet asnjë fond buxhetor për financimin e koncesionit/PPP "Ofrimi i Shërbimeve Laboratorike Spitalore".

Fondi i kursyer, i parashikuar në masën 2.2 miliardë lekë, të alokohet për rritjen e pagave të mjekëve dhe infermierëve.

Deputeti

Zija ISMAILI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6686 prot Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputetët Klodiana Çapja Belind Këllici,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 18, pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi i dytë me përmbajtje si vijon:

Gjatë vitit 2027, kontrata koncesionare/PPP "Ndërtimi i LandFillit, inceneratorit dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike", nuk do të financohet nga burimet financiare të buxhetit të shtetit.

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION
PËR AMENDAMENTIN PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga fakti se prej vitesh tashmë po financojmë nga buxheti i shtetit një kontratë koncesionare bazuar në një projekt që ende nuk ekziston.

Nisur nga denoncimet e shumta edhe nga vetë rradhët brenda mazhorancës qeverisëse mbi këtë projekt sa klientelist po aq edhe korruptiv.

Nisur nga fakti se sot janë në hetim/gjykim për korrupsion dhe shpërdorim detyre disa eksponentë të lartë të qeverisjes të viteve të fundit, ndonëse ende jo të gjithë janë vendosur para drejtësisë, sic është rasti i Kryetarit të Bashkisë Tiranë, i cili ndër të tjera ka marrë përsipër një angazhim financiar duke anashkaluar autoritetin pergjegjës sic është Këshilli Bashkiak i Tiranës.

Nisur nga mungesa e koordinimit të punës midis pushtetit vendor dhe atij qendror përsa i përket ecurisë së punës në këtë projekt fantazëm.

Nisur nga abuzimet e kryera në projekte të ngjashme në Fier dhe Elbasan, të cilat tashmë janë pranuar nga vetë qeveria si dy projekte të dështuara.

Nisur nga fakti se qeveria shqiptare dhe Bashkia Tiranë kanë shpërdoruar detyrën dhe financat publike duke kryer pagesa në mënyrë periodike, dhe me qëllim ndalimin e mëtejshëm të shpërdorimit dhe vjedhjes së parave publike,

Propozoj që të pezullohen të gjitha pagesat buxhetore për të këtë kontratë koncesionare/PPP dhe asnjë qindarkë të mos paguhet nëpërmjet thesarit të shtetit nga Qeveria dhe/apo Bashkia Tiranë për këtë projekt klientekist dhe korruptiv.

Fondi i kursyer prej 1 miliardë lekë, të rialokohet në financimin e nevojave financiare për të rritur me 25% ndihmën ekonomike të 59 mijë familjeve në Shqipëri që trajtohen nga skema sociale e ndihmës ekonomike.

Deputetet

Klodiana ÇAPJA **Belind KËLLICI**

Belind Kellici

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6685 prot

Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputetja Greta Bardeli,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në tabelën 3 "Transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2027", në kolonën "Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme 2027", vlera "29.345.000 mijë lekë" zëvendësohet me "44.017.000 mijë lekë".

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga zhvillimet e viteve të fundit, ku është konstatuar mungesa e theksuar e shërbimeve dhe investimeve tejet të nevojshme, sidomos në qarqet dhe bashkitë me të ardhura dhe nivel të ulët të jetesës (mireqenies).
Nisur nga fakti i pamundësisë së shpeshtë objektive nga ana e Njësive të Qeverisjes Vendore për të realizuar edhe ato shërbime dhe investime të programuara, si pasojë e mosrealizimit të parashikimeve të të ardhurave vendore ne nivel tremujor dhe vjetor.
Nisur nga diferencat e mëdha të konstatuara midis zonave urbane dhe atyre rurale, si në aspektin sasior ashtu edhe në aspektin cilësor, të furnizimit me shërbime dhe kryerje të investimeve,
Nisur nga nevojat akute për mbështetje financiare të njësive të qeverisjes vendore, mbi nivelet minimaliste aktuale prej 1% të PBB-së, etj,

Me qëllim adresimin e këtyre problematike, për t'iu mundësuar organeve të pushtetit lokal të realizojnë të gjitha shërbimet dhe investimet e nevojshme në njësitë administrative që përfshijnë zona rurale.

Propozoj rritjen me 50% të transfertës së pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2027.

Shtesa e propozuar mund të rialokohet nga ulja e fondeve të dedikuara për shpenzimet operative jo të domosdoshme të qeverisjes qëndrore, PPP-të me mbështetje buxhetore dhe riklasifikimi i prioriteteve të projekteve të reja të investimeve publike nga institucionet qendrore qeverisëse, pa cënuar nivelet e planifikuara të deficitit buxhetor 2027.

Deputetja

Greta BARDELI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6684 prot

Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputetët Isuf Çelaj, Ramadan Likaj dhe Flamur Hoxha

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në Tabelën 4 "Treguesit fiskal 2024-2029" në emërimin "Totali i Shpenzimeve", zëri 7 "Shpenzime të tjera" - "Ndihma ekonomike dhe Paaftësia", në kolonën "Buxheti 2027", vlera "27 200" të zëvendësohet me vlerën "32 200.
Rritja me 5 miliardë lekë do të përdoret për rritjen me 100% të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike për cdo familje përfituese të skemës mbështetëse.

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN: PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga raporti më i fundit i Eurostat, i cili konstaton se 1/3 e shqiptarëve jetojnë në varfëri dhe privim të theksuar social dhe material, duke konstatuar gjendjen e rënduar ekonomike të shumë familjeve shqiptare.

Nisur nga rritja e vazhdueshme e cmimeve, sidomos të shportës bazë së konsumit.

Nisur nga fakti dhjetëra mijëra familje, prej vitesh, marrin një trajtim financiar i cili është shumë larg nevojave reale të tyre.

Nisur nga fakti se jo vetëm nuk arrijnë dot të ezaurojnë nevojat e tyre baze me financimin aktual buxhetor, por ata përbëjnë gjithnjë e më shumë një barrë financiare edhe për familjarët / të afërmit e tyre.

Nisur nga fakti se për vitin e ardhshëm përllogariten 59 mijë familje që do duhet të përfitojnë nga kjo skemë mbështetëse.

Nisur nga sa më lart, por jo vetëm,

Propozoj alokimin e një fondi shtesë prej 5 miliardë lekë për dyfishimin e pagesave buxhetore ndaj familjeve të varfëra që trajtohen me ndihme ekonomike, më qëllim që prej 1 janar 2027 të ndërmerren hapa seriozë në luftën dhe mbështetjën konkrete ndaj kësaj shtrese të vuajtur të shoqërise shqiptare.

Fondi prej 5 miliardë lekë të alokohet nga shkurtimi i fondeve të dedikuara për shpenzimet e panevojshme operative të qeverisjes qendrore dhe fondet e parashikuara për disa PPP korruptive të cilat janë aktualisht në hetim/gjykim nga SPAK.

Deputeti

Isuf ÇELAJ **Ramadan LIKAJ** **Flamur HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6683 prot

Tiranë 24/11/2026

AMENDAMENT
PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputeti Bujar Leskaj dhe Flamur Hoxha

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në Tabelën 4 "Treguesit fiskal 2024-2029, në kolonën "Buxheti 2027", në emërtimin "Totali i Shpenzimeve", zëri 7 "Shpenzime të tjera" - "Kompensim për ish të përndjekurit politikë", vlera "2,000" të zëvendësohet me vlerën "6,000".

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset e ligjit.

RELACION:

PËR AMENDAMENTIN PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Se pari ritheksojmë talljen dhe braktisjen që qeveria i ka bërë dhjetëra mijëra ish të përndjekurve politik dhe trashëgimtarëve të tyre gjatë viteve të fundit.

Nisur nga rëndësia e lartë për Partinë Demokratike të përfundimit sa më shpejt të procesit të kompensimit financiar, me qëllim vendosjen e pjesshme të drejtësisë ndaj kësaj shtrese të përvuajtur në disa breza.

Nisur nga fakti se detyrimet financiare për të përmbyllur këtë skemë dëmshpërblimi janë rreth 280-300 milionë euro,

Nisur nga fakti i konstatuar edhe nga KLSH se me ritmet aktuale të financimit dhe ato të propozuara për vitet e ardhshme do të duhen edhe afërsisht rreth 14-15 vite për të përmbyllur shlyerjen e plotë të detyrimeve financiare ndaj përfituesve të kësaj skeme.

Nisur nga nevoja për ta përfituar në një kohë sa më të shkurtër përfitimin / shpërblimin financiar që u takon ish të përndjekurve të gjallë dhe trashëgimtarëve të tyre,

Nisur nga domosdoshmëria për të respektuar një detyrim të qartë ligjor, por edhe në funksion të drejtësisë dhe paqes sociale.

Propozoj 3-fishimin e vlerës së propozuar nga qeveria për dëmshpërblimin e shtresës së ish të përndjekurve për vitin e ardhshëm, nga 2 miliardë lekë që propozohet në projektbuxhetin 2027, në 6 miliardë lekë.

Duke ruajtur edhe për vitet e ardhshme këtë vlerë të propozuar (financim vjetor 6 miliardë lekë), procesi i dëmshpërblimit mund të përmbyllet brenda 5 viteve të ardhshme.

Ky fond shtesë të rialokohet nga reduktime të shpenzimeve operative jo të domosdoshme të qeverisjes qëndrore, pa cënuar nivelet e planifikuara të deficitit buxhetor.

Deputetët

Bujar LESKAJ **Flamur HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6696 prot

Tiranë 24/11/2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputetët Igli Cara dhe Flamur Hoxha,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 14, pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me përmbajtje si më poshtë vijon:

"Fondi i kontingjencës prej 5 miliardë lekë do të shpërndahet brenda muajit shkurt 2027 si mbështetje financiare buxhetore direkte për sipërmarrjet prodhuese, sidomos ato eksportuese, për të kompensuar efektet negative të dobësimit të euros, sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave brenda muajit janar 2027 ".

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN: PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga raportimet zyrtare të Institutit të Statistikave (Instat) ku rezulton se industria prodhuese shqiptare po përjeton një periudhë tejet të vështirë, duke e klasifikuar sektorin prodhues me një ecuri negative të saj.

Nisur nga shqetësimet e shumë prodhuesve të mesëm dhe të mëdhenj, të cilët kanë hasur vështirësi të mëdha sidomos gjatë tre viteve të fundit 2023-2026, kryesisht si pasojë e shfuqizimit të pashpjegueshëm të monedhës euro në tregun vendas,

Nisur nga fakti që një pjesë e sipërmarrjeve prodhuese shqiptare kanë falimentuar gjatë 4 viteve te fundit,

Nisur nga fakti që këto sipërmarrje vazhdojnë prej 13 vitesh të jenë nën regjimin e taksave më të larta në rajon, represionit të një administrate të paaftë dhe të korruptuar.

Nevojitet, marrja e masave urgjente për ti ardhur sadopak në ndihmë këtyre sipërmarrjeve, me qëllim kompensimin e humbjeve dhe përballimin e kësaj gjendjeje tejet shqetësuese që po përjeton ky sektor,

Ndaj për arsyet e parashtruara më lart, por jo vetëm, propozojme miratimin e një fondi kontingjence prej 5 miliardë lekë, me qëllim kompensimin e pjesshëm të humbjeve të pësuara nga prodhuesit vendas si pasojë e shfuqizimit të ndjeshëm të euros në tregun vendas.

Fondi prej 5 miliardë lekë të shpërndahet jo më vonë se shkurt 2027 sipas përcaktimeve në një vendim të posatshëm të K.Ministrave, i cili duhet miratuar brenda janarit 2027.

Ky fond kontingjencë prej 5 miliardë lekësh, të rialokohet nga fondet e parashikuara për shpenzimet operative të qeverisjes qëndrore (udhëtime, dieta, hotele, karburant, çarter etj.), dhe PPP-të me financim buxhetor, pa cënuar nivelet e defiçit të planifikuar vjetor.

Deputetët

Igli CARA **Flamur HOXHA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6695 prot Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputeti Bardh SPAHIA,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 12, shtohet pika 5/1, me përmbajtje si më poshtë vijon:

Fondi prej 3 miliardë lekësh do të përdoret për rritjen e pagave të të gjithë punonjësve në sektorin e shëndetësisë, me të paktën 30%, duke filluar nga 1 Janari 2027, sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga trajtimi jo i denjë financiar i mjekëve dhe infermierëve në Shqipëri krahasuar me homologët në vendet e rajonit dhe më gjerë.

Nisur nga fenomeni tejet i përhapur i emigrimit të një numri të madh të mjekëve dhe infermierëve gjatë viteve të fundit, si pasojë e kushteve të përgjithshme ekonomike dhe sociale në vendin tonë.

Nisur nga një nivel jo adeguat i infrastrukturës të strukturave shëndetësore, sidomos ne spitale dhe qendra shëndetësore.

Nisur nga vizioni ynë për trajtim dinjitoz financiar të mjekeve dhe infermierëve, në respekt të mundit dhe investimit të tyre personal, ku shpeshherë detyrohen të paguajnë nga xhepi i tyre kostot e formimit të vazhdueshën të detyrueshëm me ligj, dhe për shumë arsye të tjera qe nuk po i rendis në këtë relacion shoqërues.

Propozoj rritjen e pagave me të paktën 30%, me efekt që prej datës 1 janar 2027, duke vendosur një fond total të dedikuar në masën 3 miliardë lekë për rritjen e pagave për të gjithë punonjësit shëndetësorë (mjekë dhe infermierë). .

Efekti financiar i kësaj rritje mund të përballohet nga rialokimi i fondeve të parashikuara për vitin 2027 për shpenzime operative jo prioritare, rikonstruksione luksoze zyrash, mobilime dhe blerje makinash, etj.

Deputeti

Bardh SPAHIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6694 prot Tiranë 24/11/2026

AMENDAMENT

"PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008, "PËR TAKSAT KOMBËTARE, TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputeti Saimir Korreshi,

Në projektligjin "Për disa Ndryshime në Ligjin Nr.9975 "Për Taksat Kombëtare, të ndryshuar", të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Nenin 2, pika 3 hiqet:

Neni 2

Ky ndryshim reflektohet në të gjitha nenet e ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN: PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008, "PËR TAKSAT KOMBËTARE, TË NDRYSHUAR"

Amendamenti i propozuar ka si qëllim heqjen e ndryshimeve të parashikuara në këtë paketë fiskale mbi rritjen e taksës vjetore te automjeteve, duke ruajtur formulën dhe parametrat ekzistues të llogaritjes së saj.

Qëllimi ynë është shmangia e cdo rritje kostosh për pronarët e automjeteve, sidomos në kushtet kur këto mjete përdoren për punësim, veprimtari ekonomike, nevoja familjare, etj etj.

Nisur nga fakti se për shumë familje shqiptare automjeti është një mjet i domosdoshëm për të aksesuar shërbimet nga më të ndryshmet,

Nisur nga niveli jo cilësor i transportit interburban dhe urban,

Nisur nga fakti se kjo rritje e ndjeshme e propozuar nga ekzekutivi nuk ka lidhje organike me sasine e levizjeve, pra me përdorimin real të automjetit,

Nisur nga fakti se nuk ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis vjetërsisë së automjetit dhe nivele të tij ndotëse,

Nisur nga fakti se sipermarrja shqiptare do të përballet me një rritje të konsiderueshme të kostove fikse të automjeteve të tyre në pronësi,

Nisur edhe nga qëndrimi i ekzekutivit, i cili e ka ndërmarrë propozimin e rritjes së taksës fikse pa kryer asnjë konsultim paraprak me aktorët e tregut,

Propozoj anullimin e rritjes së taksës vjetore të automjeteve dhe ruajtjen ne fuqi të skemës ekzistuese, me qëllim mbrojtjen e cdo konsumatori/sipërmarrjeje ndaj kostove të pritshme në rritje nga 1 janari 2027.

Deputeti/ja

Saimir KORRESHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6693 prot

Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT

"PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.29, DATË 30.3.2023, "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputetja Jorida Tabaku,

Në projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.29, datë 30.3.2023, "Për Tatimin mbi të Ardhurat", të ndryshuar", të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 22, pikat 1a, 1b dhe 1c zëvendësohen me pikën e mëposhtme:

"një shumë prej 600 000 lekësh në vit"

Neni 2

Neni 24, pika 1, riformulohet si më poshtë:

"Të ardhurat e tatueshme nga punësimi me norma tatimore 10%".

Neni 24, pika 2, riformulohet si më poshtë:

"Të ardhurat neto të tatueshme (fitimi i tatueshëm) nga biznesi për individët tregtarë dhe të vetëpunësuarit tatohen 10%".

Neni 24, pika 3, riformulohet si më poshtë:

"Të ardhurat nga investimi tatohen me normat e mëposhtme:

(a) të ardhurat nga dividentët 8%;

(b) çdo zë tjetër i të ardhurave nga investimi 10%.

Neni 3

Këto ndryshime reflektohen në të gjitha nenet e ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.29, DATË 30.3.2023, "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT", TË NDRYSHUAR"

Propozimi synon ndryshimin rrënjësor të mënyrës së tatimit mbi te ardhurat nga punësimi dhe ruajtjen e normës ekzistuese të tatimit mbi dividentin.

Propozohet që të ardhurat nga puna të tatohen me një normë të vetme 10%, e cila zbatohet për pjesën e pagës/pagave bruto që mbetet pasi është hequr vlera prej 50 mijë lekë/ muaj. Gjithashtu propozohet që norma e dividentit të qëndrojë në nivelin 8% dhe të mos pësojë rritjen e propozuar nga qeveria, e cila parashikon praktikisht dyfishimin e tij.

Qëllimi i kësaj nismeje me ndikim të rëndësishëm social dhe ekonomik, ka si qëllim kryesor rritjen e të ardhurave të disponueshme për individët, biznneset dhe aksionerët, mbështetjen ndaj konsumit, thjeshtëzimin e llogaritjeve të detyrimeve tatimore, formalizimin e ekonomisë, etj etj.

Ulja e detyrimeve të taksapaguesve do të ishte e nj rëndësie të lartë sidomos në kuadër të rritjes së vashdueshme të cmimeve dhe kostove të jetesës.

Ulja e detyrimeve të taksapaguesve do të ndihmojë në uljen e ndjeshme të fenomenit tejet të përhapur të mosdeklarimit të një pjese të pagës. Gjithashtu kjo nisëm vjen në mbështetje të plotë edhe të kërkesave të dhomave/shoqatave të biznesit, ku taksimi i ulet sjell përfitime më të larta si për aktorët e tregut ashtu edhe për vetë arkën e shtetit në periudhën afatgjatë.

Gjithashtu ruajtja e normës aktuale e dividentit forcon parashikueshmërinë e normave tatimore dhe politikave fiskale në përgjithësi.

Thënë sa më lart, por jo vetëm, ulja e normës tatimore mbi te ardhurat personale dhe fitimin në 10% do ta pozicionojë vendin tonë Shqipërinë në mënyrë më konkurruese në rajon dhe Evropë. Propozimi përputhet me tendencën e disa vendeve të tjera për të përdorur politika fiskale lehtësuese si mjet për të stimuluar ekonominë dhe për të luftuar informalitetin.

Nëse zbatohet me sukses nga organet tatimore dhe të pushteti vendor, kjo nismë ka potencialin të sjellë përfitime afatgjata si për buxhetin e shtetit, ashtu edhe për qytetarët.

Deputetja
Jorida TABAKU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6691 prot Tiranë 24/11/2026

AMENDAMENT

"PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.92/2014 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputeti Eno Bozdo,

Në projektligjin "Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr.92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar", të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Ne fund te nenin 2, shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:

"Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar e cila aplikohet per furnizimin me energji elektrike është 6%.

Neni 2

Këto shtesa dhe ndryshime reflektohen në të gjitha nenet e ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN: PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.92/2014 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR"

Nisur nga fakti se furnizimi me energji elektrike është një shërbim thelbësor për jetën tonë të përditshme.

Nisur nga fakti se TVSH-ja është një tatim mbi konsumin dhe me ndikim të drejtpërdrejtë mbi cmimin final.

Nisur nga fakti se pesha financiare e faturës së furnizimit me energji elektrike është relativisht e konsiderueshme, sidomos për familjet me të ardhura të ulta dhe pensionistët shqiptarë, dhe cdo ulje e barrës tatimore do të përkthehej në një ndihmë direkte e relativisht e ndjeshme.

Nisur nga fakti se cdo reduktim i TVSH-së mbi furnizimin me energji elektrike përkthehet në rritje direkte dhe në të njëjtën masë të të ardhurave të disponueshme për konsum të produkteve të tjera.

Nisur nga fakti se cdo reduktim i TVSH-së do të ketë impakt në uljen e kostove të prodhimit dhe ofrimit të shërbimeve, me impakt në uljen e cmimeve finale ne treg, etj,

Propozoj shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar të furnizimit me energji elektrike në masën 6%.

Theksoj se miratimi i këtij amendamenti është thelbësor për aktorët e tregut vendas, sidomos në kuadër të vlerësimeve dhe raportimeve kombëtare dhe ndërkombëtare mbi gjendjen jo të shëndetshmë të ekonomisë shqiptare dhe varfërisë në nivele tejet të larta krahasuar me vendet e rajonit.

Deputeti

Eno BOZDO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6692 prot

Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT

"PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.92/2014 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputetët Gazment Bardhi dhe Jorida Tabaku,

Në projektligjin "Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr.92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar", të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Ne fund te nenin 2, shtohet pika 12 me këtë përmbajtje:

"Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar e cila aplikohet per furnizimin me ujë është 6%.

Neni 2

Këto shtesa dhe ndryshime reflektohen në të gjitha nenet e ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN: PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.92/2014 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR"

Nisur nga fakti se uji i pijshëm është një nevojë themelore për jetën e njeriut, shëndetit publik dhe mirënënien e qytetarëve.

Nisur nga fakti se TVSH-ja është një tatim mbi konsumin dhe me ndikim të drejtpërdrejtë mbi cmimin final.

Nisur nga fakti se pesha financiare e faturës së furnizimit me ujë është relativisht e konsiderueshme, sidomos për familjet me të ardhura të ulta dhe pensionistët shqiptarë, dhe cdo ulje e barrës tatimore do të përkthehej në një ndihmë direkte financiare dhe relativisht e ndjeshme për ta.

Nisur nga fakti se cdo reduktim i TVSH-së mbi furnizimin me ujë përkthehet në rritje direkte dhe në të njëjtën masë të të ardhurave të disponueshme për konsum të produkteve të tjera.

Nisur nga fakti se cdo reduktim i TVSH-së mbi furnizimin me ujë do të ketë impakt në uljen e kostove të veprimtarive ekonomike si ato në sektorin bujqësor, industri ushqimore, hoteleri, bare&restorante, etj etj,

Propozoj shkallën e reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar të furnizimit me ujë në masën 6%.

Për më tepër, nisur nga kriza ekonomike tejet e përhapur dhe nivelet e larta të varfërise, sidomos edhe pas vlerësimeve të Eurostat, ku 1/3 e shqiptarëve jetojnë në varfëri dhe privim social & material, theksoj se miratimi i këtij amendamenti do të ishte një instrument i rëndësishëm, ndonëse jo i mjaftueshëm, për të përmirësuar disi jetën e shqiptarëve dhe fuqizuar sadopak aktorët e ekonomisë.

Deputetët

Gazment BARDHI **Jorida TABAKU**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6702 prot Tiranë 24/11/2026

AMENDAMENT

"PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.92/2014 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputetja Ledina Aliolli,

Në projektligjin "Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin Nr.92/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar", të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Nenin 1 hiqet:

Neni 2

Ky ndryshim reflektohet në të gjitha nenet e ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN: PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.92/2014 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR"

Qëllimi i këtij amendamenti është mos lejimi i rritjes së normës bazë të tatimit mbi vlerën e shtuar ne 21%.

Propozimi synon ruajtjen e nivelit ekzistues të tatimit mbi konsumin, me qëllim shpangien e një rritjeje të përgjithshmë të barrës tartimore mbi furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, gjithmonë për ato që i nënshtrohen shkallës standarte.

Gjithashtu nisur nga fakti se tatimi mbi vlerën e shtuar është një komponent i rëndësishëm i cmimit përfundimtar që paguan konsumatori shqiptar, ku sipas vetë vlerësimeve të qeverisë shqiptare rritja në 21% e normës së TVSH-së do tu kushtojë konsumatorëvë pothuajse 120 milionë euro.

Nisur nga fakti se sidomos shtresat me të ardhura të ulta do të preken akoma edhe më shumë pasi pjesën dërrmuese të të ardhurave të tyre e cojnë për konsum.

Nisur nga fakti që rritja e normës së tatimit mbi vlerën e shtuar do të ketë ndikim edhe në rritjen e normës së inflacionit.

Nisur nga fakti se kjo rritje do të shoqërohet edhe me masën tjetër të propozuar nga ekzekutivi, sic është ajo e uljes së pragut të tatimit të vlerës së shtuar në 5 milionë lekë xhiro vjetore, etj etj,

Propozoj anullimin e propozimit të ekzekutivit shqiptar për rritjen në 21% të normës së tatimit mbi vlerën e shtuar.

Miratimi i këtij amendamenti është i një rëndësie të lartë si për konsumatorin shqiptar ashtu edhe për aktorët e tjerë të tregut.

Deputetja

Ledina ALIOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6701 prot

Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputeti Luan Baçi,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në tabelën 1 "Buxheti 2027 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore", në rreshtin 5 "Ministria e Bujqësise dhe Zhvillimit Rural", programi " Zhvillimi Rural duke mbësht. Prodh. Bujq, Blek, Agroind dhe Market", në kolonën "Totali i shpenzimeve buxhetore", vlera "8.431.866 mijë lekë" zëvëndësohet me "19.200.000 mijë lekë".

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN: PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga rëndësia e bujqësisë, blegtorisë dhe agrobiznesit në zhvillimin e ekonomisë së brendshme shqiptare,

Nisur nga fakti, vërtetuar edhe nga publikimet e Instat-it, që prej disa vitesh tashmë ky sektor po përjeton një recesion të pandalshëm,

Nisur nga fakti që pjesa dërrmuese e produkteve që konsumohen jo vetëm nga popullata shqiptare por edhe nga turistët e huaj, nuk janë prodhime vendase por produkte të importuara,

Nisur nga fakti që rreth 45% e popullatës shqiptare jeton dhe punon në zonat rurale,

Nisur nga gjendja jo e mirë e sektorit të bujqësisë, e cila performon në nivele tejet larg potencialeve të saj reale dhe pritshmërive,

Nisur nga fakti që fondet e Ipard-it vazhdojnë të jenë të bllokuara nga strukturat e BE-se,

Nisur nga nevojat e sektorit të bujqësisë për tu mbështetur financiarisht nga buxheti i shtetit nëpërmjet subvencioneve direkte, dhe sidomos nisur nga fakti që Shqipëria renditet e fundit në rajon përsa i përket mbështetjes direkte ndaj fermerit,

Propozoj trefishimin e fondit vjetor të parashikuar në buxhetin 2027 për subvencionimin e fermerëve, blegtorëve dhe agrobiznesit, me qëllim sigurimin e fondeve të nevojshme për të mbështetur realisht këtë sektor në formën e subvencioneve dhe fuqizimin e prodhuesve vendas sidomos krahasuar me ata të vendeve fqinjë.

Efektet financiare në Buxhetin e Shtetit do të përballohen nga ulja në të njëjtën masë të rishikimit të financimit të projekteve të reja dhe jo të domosdoshme të investimeve publike, shpenzimeve operative të panevojshme të qeverisjes qendrore, shpenzimeve të orientuara drejt lukseve qeveritare dhe kontratave koncesionare/PPP.

Deputeti

Luan BAÇI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6699 prot

Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputeti Kliti Hoti,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 5, pika 2, të ndryshohet si më poshtë vijon:

"Vlera 14 500 milionë lekë zëvendësohet më vlerën 29 000 milionë lekë".

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN
PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga fakti që sipas Eurostat në Shqipëri mbi 1/3 e shqiptarëve jetojnë në kushtet e varfërisë dhe privimit social dhe material.
Nisur nga nevojat e shumta për trajtim me medikamente për të sëmuret e të gjitha moshave, por sidomos të moshës së tretë.
Nisur nga fakti që në 13 vitet e fundit nuk është kryer asnjë rritje reale pensionesh, por vetëm indeksime pjesore të tyre, e cila është shoqeruar me rënie të fuqisë reale blerëse të pensionistëve shqiptarë, ashtu sic vërtetohet lehtë edhe nga të dhënat e Instat-it.
Nisur nga fakti që në projektbuxhetin 2027 janë parashikuar për rimbursimin e medikamenteve fonde me një rritje të lehtë krahasuar me buxhetin e vitit korent 2026.

Propozoj, dyfishimin e fondit të propozuar në projektbuxhet 2027 që dedikohet për rimbursimin e ilaceve, duke e cuar atë në vlerën 29 miliardë lekë, me qëllimin e vetëm që vitin e ardhshëm të reduktojmë ndjeshëm shqetësimet e qindra mijëra nevojtarëve që vuajnë nga sëmundje nga më të ndryshmet dhe që me fondet e buxhetit të shtetit të mbulohen nevojat e mbi 90% të kërkesës reale, ndryshe nga aktualisht ku rreth vetëm gjysma e ilaceve të nevojshme rimbursohen nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër rëndon në xhepat e familjeve dhe pensionistëve shqiptarë.

Për këtë nevojitet një fond shtesë prej 14.5 miliardë lekësh, të cilat janë lehtësisht të rialokueshme nga reduktimi i fondeve të dedikuara për shpenzimet operative jo prioritare të qeverisjes qëndrore (udhëtime, dieta, hotele, karburant, çarter etj.), dhe pezullimi i pagesave të PPP-ve, pa cënuar nivelet e defiçit të planifikuar vjetor.

Deputeti

Kliti HOTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6713 prot

Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputeti Kastriot Piroli,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në tabelën 1 "Buxheti 2027 sipas ministrive të linjës dhe institucioneve buxhetore", në rreshtin 11 "Ministria e Arsimit", kolonën "Totali i shpenzimeve buxhetore", vlera "67.953.438 mijë lekë" zëvendësohet me "97.298.758 mijë lekë".

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga zhvillimet dramatike demografike të dekatës së fundit, ku emigrimi sidomos i të rinjvë ka qenë dhe mbetet në nivele alarmante.

Nisur nga vleresimet shqetësuese te PISA-s mbi gjendjen dhe performancën tejet të dobet të sektorit të arsimit në Shqipëri.

Nisur nga nevojat akute per te rritur financimin e sektorit arsimor, i cili ndër vite ka qenë i nënfinancuar krahasuar me nevojat reale, ku sipas të dhënave financimi real i propozuar per vitin 2027 ndaj sektorit të arsimit mbetet në të njëjta nivele në raport me PBB-në si në vitin korent 2026.

Nisur nga qëllimi për rritjen e cilësisë së mësimdhënies në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar dhe universitar, rritjen e investimeve në infrastrukturë shkollore, etj.

Nisur nga nevoja për rritje të qenësishme të pagave të mësuesve dhe pedagogëve.

Nisur edhe nga nevojat për një mbështetje konkrete financiare për studentët me të ardhura familjare të ulta,

propozoj rritjen graduale me 1% të PBB-së të buxhetit 2027 për Ministrinë e Arsimit, me qëllim që në të ardhmen e afërt (brenda vitit 2029) ky sektor të financohet me të paktën 5% të PBB-së.

Efektet financiare në Buxhetin e Shtetit do të përballohen nga ulja në të njëjtën masë të shpenzimeve operative të panevojshme qeveritare, kontratave koncesionare/PPP dhe projekteve të reja jo prioritare të investimeve publike.

Deputeti

Kastriot PIROLI

2026.

Nr. 6712 prot.
24. 11. 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputeti Gjin Gjoni,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 14, shtohet pika 4, me përmbajtje si më poshtë vijon:

"Fondi i kontingjencës prej 1 miliardë lekë i dedikuar për qarkun Lezhë, do të shpërndahet si kompensim financiar ndaj banorëve dhe bizneseve, pronat e të cilëve janë dëmtuar nga përmbytjet e ndodhura gjatë muajve tetor-dhjetor 2025. Kompensimi financiar ndaj banorëve dhe bizneseve do të jepet sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave, i cili do të miratohet brenda muajit shkurt 2027".

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN: PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN

"PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Qarku i Lezhës u përball me përmbytje të medha gjatë fundit tw vitit 2025.

Sipas informacioneve zyrtare ishin afërsisht 500 ha tokë bujqësore e pwrmbytur, e cila u përkthye në humbje të mëdha për banorët e zonës.

Sipas informacioneve zyrtare janë me mijëra dëmtimet e konstatuara në gjënë e gjallë dhe shpendët.

Gjithashtu dëme të konsiderueshme u konstatuan edhe në ushqimin për blegtorinë dhe rezervat që ishin ruajtur/magazinuar për ti bërë ballë muajve të ftohtë të dimrit.

Për më tepër, të shumta ishin edhe dëmtimet në infrastrukturën e zonave të ndryshme të qarkut dhe kanaleve të ujitjes dhe kullimit. Zonat ku konstatohen dëme më të mëdha ishin njësitë administrative Tale, Kolsh, Fushë Kuqe. Nga nivelet e larta të prurjeve të ujit, ura në fshatin Jezull në bashkinë Mirditë pwsoi dëmtime.

Për sa më sipër, por jo vetëm,

Për këtë arsye propozoj këtë amendament për alokimin e një fondi prej 1 miliardë lekë për kompensimin e dëmeve në bujqësi, kompensimin e dëmeve në banesa dhe infrastrukturën bazë të familjeve të prekura në Qarkun e Lezhës.

Propozoj që këto fonde të rialokohen nga fondet e planifikuara për projektet e reja të investimeve publike të cilat lehtësisht mund të shtyhen në kohë për realizimin e tyre, pa cenuar zhvillimin ekonomik të vendit dhe zonave përfituese të atyre projekteve.

Kompensimi i dëmeve është emergjent, dhe është gjithashtu edhe një e drejtë që duhet garantuar për hir të stabilitetit social dhe ekonomik të zonës.

Deputeti

Gjin GJONI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6711 prot Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputeti Igli Cara,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Neni 4, pika 3 riformulohet si më poshtë vijon:

Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 24 003 milionë lekë.
Ky fond ndahen midis skemave dhe përdoren sipas përcaktimeve në vendimet e Këshillit të Ministrave.
Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN: PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga vlerësimet më të fundit mbi nivelet e larta të varfërisë, sidomos në shtresën e pensionistëve shqiptare,

Nisur nga fakti i ditur nga cdokush, por sidomos nga vetë pensionistët, që pensionet e tyre po humbasin vit pas viti edhe atë fuqi të ulët reale blerësë, si pasojë e rritjes së vazhdueshme të cmimeve, sidomos të mallrave ushqimore të shportës bazë.

Nisur nga fakti që në 13 vitet e fundit qeveria është tallur me pensionistët duke u munduar t'u mbushë mendjen thjesht me propagande dhe asnje tjetër, pasi vetëm indeksime pjesore të tyre janë ndërmarrë dhe jo rritje reale pensionesh.

Nisur nga fakti që pensionet në Shqipëri janë më të ultat në Europë.

Nisur nga fakti që në projektbuxhetin 2027 janë parashikuar fondet për indeksimin e pensioneve dhe bonusin e pensionistëve, në dy skema të ndara nga njëra tjetra, konkretisht 4 miliardë lekë dhe 20 miliardë lekë,

Propozoj që në projektbuxhetin e vitit të ardhshëm, e gjithë vlera prej 24 miliardë lekësh të jetë e dedikuar për rritjen reale të pensioneve, dhe jo për bonuse elektorale.

Qëllimi është i thjeshtë: pensionistët meritojnë të kenë të drejta të përhershme dhe jo të varen nga vendimet momentale/elektorale të cdo forceje qeverisëse, pavarësisht kushdo qoftë ajo.

Ky propozim nuk ka asnjë efekt financiar mbi buxhetin e shtetit 2027.

Deputeti

Igli CARA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6718 prot Tiranë 24/11/2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputetja Ina Zhupa,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 12, shtohet pika 5/1, me përmbajtje si më poshtë vijon:

Fondi prej 10 miliardë lekësh do të përdoret për rritjen e pagave të të gjithë mësuesit dhe pedagogët në sektorin e arsimit, me të paktën 30%, duke filluar nga 1 Janari 2027, sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga braktisja 12 vjecare që i është bërë mësuesve dhe pedagogeve, të cilët mbeten më pak të paguar krahasuar me homologët e tyre në rajon e më gjerë.

Nisur nga shqetësimi ndaj fenomenit të migrimit të mesuesve nga zonat rurale drejt atyre urbane, apo largimit të pedagogëve jashtë vendit, fenomen i cili është ushqyer ndjeshëm si pasojë e niveleve të ulta të shpërblimit financiar (pagave).

Nisur nga kostot e formimit të vazhdueshëm që shpeshherë përballohen kryesisht nga vetë financat personale të mësuesve dhe pedagogëve,

Nisur nga misioni i lartë fisnik i edukimit dhe formimit të brezave të ardhshëm, mision që ja kemi ngarkuar mijëra mësuesve dhe pedagogëve, si të sistemit parauniversitar ashtu edhe universitar, e shumë arsye të tjera që nuk po i përmend.

Propozoj përcaktimin në buxhetin 2027 të një fondi të dedikuar me vlerë prej 10 miliardë lekë për rritjen e pagave të mesuesve dhe pedagogëve, të paktën në masën 30%. Rritja e pagave të mesuesve dhe pedagogëve të fillojë efektet e saj që prej datës 1 janar 2027, sipas përcaktimeve që do të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave gjatë muajit dhjetor 2026.

Ky fond mund të sigurohet lehtësisht nga rialokimi i fondeve të dedikuara për shpenzimet operative të panevojshme të qeverisjes qëndrore dhe eliminimi i cdo shpenzimi për rikonstruksione dhe mobilime godinash e zyrash të administratës qendrore dhe institucioneve të tyre të varësisë.

Deputeti/ja

Ina ZHUPA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6717 prot Tiranë 24/11/2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputetja Ina Zhupa,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 16, pas gërmës "c", me emërtimin "granti i punës kërkimore, shkencore dhe veprimtarive krijuese", shtohet fjalia me përmbajtje si më poshtë vijon:

"Vlera e alokuar për vitin 2027 do të jetë të paktën 3 000 milionë lekë".

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN: PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN

"PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga nivelet tejet të ulta të kërkimit shkencor nga trupat përkatesë akademike dhe jo vetëm.

Nisur nga fakti se prej vitesh, universitetet publike vuajnë nga mungesa e mbështetjes financiare për realizimin e projekteve kërkimore, të cilat aktualisht përballohen nga vetë stafet akademike, duke rënduar shpeshherë ndjeshëm në xhepin e tyre.

Nisur nga fakti mbi shqetësimet e bëra publike nga vetë trupat akademike të universiteteve publike, të cilat kanë ngritur prej vitesh zërin mbi pamjaftueshmërinë e fondit të dedikuar për punën kërkimore, shkencore dhe veprimtaritë krijuese, duke rezultuar shumë larg nevojave reale dhe krejtësisht i pamjaftueshëm për realizimin e kërkimeve të nevojshme shkencore nga ana e personelit të institucioneve të arsimit të lartë.

Me qëllim që universitetet publike dhe stafet e tyre të mbështeten mjaftueshëm me fonde për realizimin e projekteve kërkimore, shkencore dhe krijuese.

Propozoj që granti i dedikuar në buxhetin 2027 të jetë të paktën 3 miliardë lekë, apo të paktën 0.1% të PBB-së.

Shqipëria sot ka më shumë nevojë për punën kërkimore shkencore se sa të shpenzojë paratë e taksapaguesve për godina e zyra luksi, udhëtime, fatura charterash, etj.

Efekti shtesë financiar të përballohen nga ulja në të njëjtën masë të shpenzimeve operative të qeverisjes qendrore.

Deputetja

Ina ZHUPA

Nr. 6715 prot
24.11.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputetja Greta Bardeli,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 14, shtohet pika 4, me përmbajtje si më poshtë vijon:

"Fondi i kontingjencës prej 1 miliardë lekë do të shpërndahet si kompensim financiar ndaj banorëve dhe bizneseve të qarkut Shkodër, pronat e të cilëve janë përmbytur gjatë viteve të fundit.
Fondi do të shpërndahet sipas përcaktimeve me vendim të Keshillit të Ministrave".

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

<u>R E L A C I O N</u> PËR AMENDAMENTIN PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Fatkeqësitë natyrore kanë shkaktuar shpeshherë dëme të konsiderueshme ne ekonomitë rajonale të zonave të prekura. Përmbytjet, tërmetet, zjarret në bimësi dhe në pyje, rrëshqitjet e tokës dhe rreziqet e tjera dhe pasojat e tyre kanë një ndikim të konsiderueshëm në komunitet, ne jete njerezish, ekonomi, infrastrukturë dhe mjedis.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë ato që përballen që në fillim me fatkeqësitë, por fatkeqësisht konstatohet një braktisje nga ana e qeverisjes qendrore dhe mbeshtetjes me fonde buxhetore për të koompensuar disi humbjet e pësuara.

Konkretisht, nga këto përmbytje gati të përvitshme, në qarkut e Shkodrës janë konstatuar dëme jo vetëm në banesa, por janë përmbytur 1 mijë e 600 ha tokë, e cila përfshin kultura bujqësore, blegtori dhe biznese të zonave.

Nga përmbytjet e ndodhura në Shkodër në vitin 2018, vlera e perllogaritur e këtyre dëmeve kapi vlerën prej 310.974.940 lekë. Nga përmbytjet e ndodhura në Shkodër në vitin 2021, vlera e përllogaritur e këtyre dëmeve kapi vlerën prej 801,661,519 lekë. Por asnjë dëmshpërblim nuk pati për këto dëme.

Qeveria asnjëherë nuk e shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore të pjesshme, një detyrim kushtetues ndaj qytetarëve, i lidhur me përgjegjësinë për të kompensuar dëmet, një diskriminim i qartë ndaj Veriut, por në veçanti ndaj Shkodrës. Të ardhurat nga burimet ujore, energjia elektrike e prodhuar nga hidrocentralet, është një pasuri kombëtare, e cila duhet të jetë e tillë edhe në rastet e emergjencave. Veriut i takon të marrë pjesën nga kjo e ardhur, duke pasur parasysh dëmet që shkaktohen, pra duhet të marrin dëmshpërblimin e tyre. Nisur nga shqetësimet e përmendura më lart, *Propozoj miratimin e një fondi kontingjence prej 1 miliardë lekë, për tu shpërndarë sipas përcaktimeve me VKM, me qëllim dëmshpërblimin e dëmeve nga përmbytjet në qarkun e Shkodrës. .*

Ky fond kontingjencë prej 1 miliardë lekësh, të rialokohet nga fondet e dedikuara për shpenzimet operative të panevojshme dhe jo prioritare të qeverisjes qëndrore (udhëtime, dieta, hotele, karburant, çarter etj.).

Deputetja
Greta BARDELI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6732 prot

Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Deputeti Oerd Bylykbashi,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 18, pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi i dytë me përmbajtje si vijon:

"Gjatë vitit 2027, nuk do të financohet nga burimet financiare të buxhetit të shtetit asnjë kontratë koncesionare/PPP

Neni 2

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN: PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN

"PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Nisur nga skandalet e shumta që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me planifikimin dhe shpenzimet e kryera nga qeveria me paratë e buxhetit të shtetit.

Nisur nga fakti se kontratat koncesionare / PPP të cilat prej vitesh financohen nga buxheti i shtetit, kanë rezultuar me shkelje të shumta ligjore.

Nisur nga fakti se një pjesë e mirë e këtyre kontratave koncesionare/PPP janë aktualisht edhe nën hetim/gjykim për korrupsion dhe shpërdorim detyre nga Struktura e Posacme Anti-Korrupsion.

Nisur nga mungesa e raporteve periodike mbi ecurinë e zbatimit të këtyre kontratave.

Nisur nga konstatimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi abuzimet financiare në financimin e shumë prej këtyre kontratave koncesionare.

Nisur nga fakti se në filozofinë e Partisë Demokratike, asnjë qindarkë e shqiptarëve nuk duhet lejuar që të abuzohet apo vidhet me afera korruptive dhe haptazi klienteliste.

Me qëllim ndalimin e shpërdorimit dhe vjedhjes së parave publike gjatë vitit të ardhshëm 2026.

Propozoj që të pezullohen të gjitha pagesat buxhetore për të gjitha kontratat koncesionare/PPP.

Fondet e kursyera prej 10 miliarde lekësh, të rialokohen në financimin e nevojave financiare për rritjen e pagave dhe financimin e skemës së ilaceve të rimbursueshme.

Deputeti/ja

Oerd BYLYKBASHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 6735 prot Tiranë 24 / 11 /2026

AMENDAMENT

PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN "PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Në mbështetje të nenit 75 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,

Në projektligjin "Për Buxhetin e Vitit 2027", të bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 4, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtëvijon:

Vendosja e një fondi 2.99 miliard lek për dhënien e pagës së trembëdhjetë, të gjithë mësuesve të arsimit parauniversitar.

Neni 2

Kompensimi financiar ndaj mësuesve sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave, i cili do të miratohet brenda muajit qershorit 2027".

Neni 3

Ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat dhe anekset shoqëruese të ligjit.

Deputete

Ina Zhupa

RELACION

PËR AMENDAMENTIN: PËR DISA NDRYSHIME NË PROJEKTLIGJIN

"PËR BUXHETIN E VITIT 2027"

Amendamenti propozon ndryshimin e dispozitave përkatëse të legjislacionit financiar dhe të statusit të punonjësve të arsimit parauniversitar, me qëllim përfshirjen e pagës së 13-të si shpërblim vjetor i detyrueshëm për të gjithë mësuesit e sistemit arsimor parauniversitar publik.

Ky amendament synon:

- Rritjen e motivimit profesional të mësuesve përmes një skeme të qartë shpërblimi.
- Vlerësimin e rolit të mësuesve në formimin e brezit të ri, në përputhje me standardet e vendeve europiane.
- Përmirësimin e kushteve ekonomike të mësuesve, duke ulur presionin financiar dhe nxitur qëndrueshmërinë në profesion.
- Reduktimin e largimeve nga profesioni dhe të deficitit të mësuesve në disa profile.

Në skemën aktuale të pagave për mësuesit, pavarësisht shtesave për kualifikimin dhe vjetërsinë, nuk parashikohet një shpërblim vjetor i standardizuar në formën e pagës së 13-të.
Mësuesit përballen me:

- rritje të kostove të jetesës,
- barrë të madhe pune jo të paguar (korrigjime, përgatitje mësimore, punë administrative),
- veçanërisht mungesë motivimi financiar krahasuar me profesione të tjera të sektorit publik.

Futja e pagës së 13-të:

- përmirëson stabilitetin financiar të familjeve të mësuesve;
- përbën një instrument motivues dhe përforcues të cilësisë së arsimit;
- ndikon në rritjen e cilësisë së shërbimit arsimor për nxënësit;
- sjell përfitime afatgjata në cilësinë e kapitalit njerëzor të vendit.

Shumë vende europiane parashikojnë forma të shpërblimeve vjetore, bonuse apo paga të 13-ta për punonjësit e sektorit publik, veçanërisht në arsim, si mjet për të ruajtur cilësinë dhe për të motivuar stafin.
Ky amendament e afron Shqipërinë me praktikat e vendeve të BE-së.

Paga e 13-të llogaritet mbi pagën bazë vjetore të mësuesit.

Ndikimi buxhetor është:

- i përballueshëm brenda rritjes së parashikuar të buxhetit për arsimin;
- i justifikuar nga përfitimet sociale e arsimore afatgjata;
- i harmonizuar me objektivat e qeverisjes për rritjen e pagave në sektorin publik.

Nëse kërkohet, mund të shtoj tabelë me vlerësime financiare paraprake.

Amendamenti është në përputhje me:

- Strategjinë Kombëtare të Arsimit që parashikon rritjen e cilësisë së mësimdhënies;
- politikat e rritjes së vlerësimit të profesionit të mësuesit;
- objektivat për rritjen e pagave dhe motivimit të stafit arsimor.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e rolit të mësuesit në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit, mungesën e një skeme të qëndrueshme shpërblimi vjetor, si dhe praktikat e vendeve të zhvilluara, propozohet miratimi i amendamentit që parashikon pagën e 13-të për të gjithë mësuesit e arsimit parauniversitar.

Ky amendament përbën një hap të domosdoshëm drejt rritjes së vlerësimit profesional të mësuesve dhe forcimit të cilësisë së sistemit arsimor.

Deputete